



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

MEMO

MBI MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MES BASHKISË SHKODËR DHE FONDACIONIT “HOPE FOR THE WORLD”

Pranë bashkisë Shkodër është administruar Akt- Marrëveshja nga Fondacioni “Hope for the World” për realizimin e bashkëpunimit për përmirësimin e kushteve për përkujdesjen, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç, Shtëpisë së Fëmijës 6-15 vjeç, Strehëzës për fëmijë pa kujdes prindëror dhe klientëve të Qendrës së Zhvillimit, Shkodër.

Të gjitha aktivitetet e cituara në këtë Marrëveshje do të bazohen mbi parimin e reciprocitetit, vullnetit të mirë, fleksibilitetit dhe cilësisë.

Me nënshkrimin e marrëveshjes palët përmbushin detyrimet e veta, të cilat janë të përcaktuara qartë në të.

Kjo akt- marrëveshje bashkëpunimi hartohet mbi bazën e dispozitave ligjore si më poshtë:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr .10221 , datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr.10071, datë 09.02.2009 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”;
- VKM –në nr.658 datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”;
- VKM – në nr.149, datë 13. 03. 2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;
- VKM -në nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;

- VKM nr.465, datë 03.07.2019 “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/të dëmshme në internet”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa e OKB-së “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, datë 20.11.1989.

Sa më sipër, bashkëlidhur dokumenti për t’u nënshkruar.


**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

DREJTOR
Denis LËSHA




**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE
SHËNDETIT PUBLIK**

Specialist: R. Sytari




DREJTOR
Arlinda KRUJA



DREJTORIA JURIDIKE

Specialist: M. Fushaxhia, S. Kollaçej, Y. Durrëj

DREJTOR
Brikena LEQEJZA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

Nr. 1493 Prot
Shkodër, më 27. 01. 2025



HOPE FOR THE WORLD

**FONDACIONI
“HOPE FOR THE WORLD”**

Nr. 4 Prot
Shkodër, më 27. 01. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë 27 / 01 / 2025, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër, me Kryetar të Bashkisë z. Benet BECI, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nga Zv/Kryetari z. Onid BEJLERI, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. 13 dhjetori, Shkodër, këtej e tutje e cilësuar si “Bashkia”.

dhe

Fondacionit “Hope for the World”, regjistruar sipas vendimit të gjykatës nr.174, dt. 04.01.1996, me nr. NIPT J62214001L, si dhe me licensë nga QKL për ‘Shërbime të Përkujdesit Rezidencial’ LN-2747-01-2011, përfaqësuar nga z.**Alfred Zefi**, mbajtës i kartës së identitetit me nr.letërnjoftimi 032318024, nr.personal H70412127B në cilësinë e drejtorit, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresa: Rr. “Kukle”, Shkodër.

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr .10221 , datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr.10071, datë 09.02.2009 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”;

- VKM –në nr.658 datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”;
- VKM – në nr.149, datë 13. 03. 2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;
- VKM -në nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
- VKM nr.465, datë 03.07.2019 “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/të dëmshme në internet”;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa e OKB-së “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, datë 20.11.1989.

NENI 1

OBJEKTI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për objekt përmirësimin e kushteve për përkujdesjen, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç, Shtëpisë së Fëmijës 6-15 vjeç, Strehëzës për fëmijë pa kujdes prindëror dhe klientëve të Qendrës së Zhvillimit, Shkodër.

NENI 2

DETYRIMET E PALËVE

1. Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtoritë e Shtëpive të Fëmijëve 0-5 vjeç, 6-15 vjeç, Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror dhe Qendrën e Zhvillimit marrin përsipër:

- Të jenë disponibël me përfaqësuesit e Fondacionit “Hope for the World” për t’u ofruar të dhënat personale të fëmijëve që kanë të bëjnë me lindjen, prejardhjen, edukimin, karakterin, prirjet etj, për të mundësuar veprimin sa më funksional të aktivitetit të Fondacionit.
- Të lejojnë vizita miqësore të individëve apo grupeve të ndryshme misionarësh të huaj, të organizuara nga fondacioni, të cilët edhe mund të kontribuojnë në ndihmë të institucionit.
- Të lejojnë vendosjen e mjeteve promociionale (postera, foto, etj.) të Fondacionit “Hope for the World” në ambjentet e Shtëpive të Fëmijëve, Strehëzës për fëmijë pa kujdes prindëror dhe Qendrës së Zhvillimit.
- Të sigurojë një ambient që do të shërbejë për aktivitete edukativo-kulturore që do të kryhen nga punonjësi i Fondacionit “Hope for the World” në bashkëpunim me Shtëpitë e Fëmijëve, Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror dhe Qendrën e Zhvillimit.
- Për aktivitetet, kremtimin e ditëlindjeve, blerjen e dhuratave dhe detyra të ngjashme me to, të jenë të pranishëm edhe edukatorë apo përfaqësues të institucioneve respektive.

- Të paraqesin faturat e shpenzimeve të aktiviteteve që mbulohen financiarisht nga fondacioni pranë përfaqësuesit të fondacionit.
- Për mirëmbajtjen e ambjenteve të institucioneve, më parë duhet të konfirmohet projekti dhe preventivi nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë së Shkodrës dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë së Shkodrës dhe gjithashtu nga fondacioni “Hope for the World”.
- Zbatimin e ligjeve dhe rregullave për administrimin e kontributit material e financiar të Fondacionit “Hope for the World”.

2.Fondacioni “Hope for the World”, nëpërmjet përfaqësuesit vendor të tij, në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura, merr përsipër:

- Projektin: **“Të gëzojmë dhe festojmë së bashku”**.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht ditëlindjen e secilit fëmijë/klient të këtyre qendrave, për kremtimin sa më të mirë të ditëlindjeve të fëmijëve dhe për bërjen e dhuratave të ndryshme për ta, në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë \$760, në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$ 1200 ,në Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror, në vlerë \$280 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$1620.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht **kremtimin e festave ndërvjetore** në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë \$500, në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$1540 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$700.
- Projektin **“Përfshirje në aktivitete kulturore-sportive”**.
- Të nxisë dhe të mbështesë talentet e reja në pikturë, muzikë, sport etj, në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë \$200, në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$ 1200 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$500.
- Projektin **“Të shijojmë natyrën”**.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me fëmijët në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë \$600, në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$1220, në Strehëz \$360 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$1000.
- Të mbështesë për **“Pushimet Verore”** në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$600 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$1000.
- Projektin **“Jemi afër”**.
- Të mbështesë, transportin (çmim bilete) për takimet e familjarëve me fëmijët e tyre të cilët jetojnë në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë \$200 dhe në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$300.
- Të mbështesë për **projekte** tek Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$1000, tek Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror \$800 dhe tek Qendra e Zhvillimit me vlerë \$1000.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht kremtimin e festave të Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri si dhe bërjen e dhuratave të ndryshme në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç me vlerë

\$600, në Shtëpinë e Fëmijës 6-15 vjeç me vlerë \$1380, në Strehëz \$360 dhe Qendrën e Zhvillimit me vlerë \$2460.

- Kontributi financiar për mbështetjen e aktiviteteve të sipërpërmendura do të jetë i ndryshueshëm për çdo muaj në varësi të numrit të fëmijëve në institucion.
- Shpenzimet e përgjithshme vjetore që do të mbështesë fondacioni për Shtëpitë e Fëmijës dhe Qendrën e Zhvillimit do të jenë me vlerë \$21380 në total, të ndara sipas institucioneve: Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç vlerë \$ 2860, Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç vlerë \$8440, Strehëza \$1800 dhe Qendra e Zhvillimit \$ 8280.
- Fondacioni mirëpret brenda muajit Maj 2025 projekte me vlerë deri në 3000\$, për t'u përfshirë në marrëveshjen e bashkëpunimit për vitin 2026.
- Fondacioni paraqet raport narrativ dhe financiar 6 mujor, mbi ndërhyrjet, mbështetjen dhe aktivitetet e zhvilluara në shtëpinë e fëmijëve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik, në Bashkinë Shkodër dhe gjithashtu pranë Zyrës Qendrore të Fondacionit "Hope for the World".

NENI 4

NIVELI I SHËRBIMEVE I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Këto shërbime do të kryhen në përputhje me standartet, kushtet dhe normativat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Marrëveshja e bashkëpunimit detyron:

- Drejtoritë e Institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër dhe Fondacionin "Hope for the World" që të informojë në organet përkatëse të Bashkisë Shkodër, mbi ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë Shkodër të monitorojë mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe shërbimeve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

NENI 5

ZBATIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partnerë në zbatimin e saj dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.

NENI 6

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri 31 dhjetor 2025.

NENI 7

PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Secila nga palët mund të përfundojë këtë marrëveshje në rastet kur:

- a. Mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
- b. Shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- c. Palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- d. Për forcë madhore.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 8

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët, në të kundërt palët kanë të drejtën t'i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës kompetente.

NENI 9

DISPOZITA TË FUNDIT

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga palët.

NENI 10

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Z. Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Zv/KRYETAR

Omid BEJLERI



**PËR
FONDACIONIN "HOPE FOR THE
WORLD", DEGA SHKODËR**

DREJTOR

Z. Alfred ZEFI

